



MEGATEK sha
Pasqyrat Financiare 31.12.2018
(individuale – jo të konsoliduara)

Mars – 2019

MEGATEK sha

NIPT: K81607050Q

Aktiviteti: Manaxhim Qendre Tregtare,
tregtim me shumicë i produkteve industrial etj.

Adresa: Autostrada Tiranë – Durrës, km 6 Kashar - Tiranë

Periudha Kontabël e Pasqyrave
Financiare:

Nga 01.01.2018

Deri 31.12.2018

Data e mbylljes së PF – 27.03.2019

Monedha: në lekë

Shkalla e rrumbullakimit: në 1 (një) lekë

Kuadri ligjor: Ligji Nr. 9228 datë 29.04.2004
"Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"

Kuadri kontabël i aplikuar: Standartet
Kombëtare të Kontabilitetit në Shqipëri

Tabela e përmbajtjes

A. BILANCI KONTABËL	3
B. PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	5
C. PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË.....	6
D. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALET E VETA	7
E. SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE	8

Pasqyrat Financiare 2018

MEGATEK sha BILANCI KONTABËL

Për vitet ushtrimor të mbyllur më 31.12.2018 dhe 31.12.2017
(Të gjitha balancat janë në lekë).

	A K T I V E T	Shënime	Ushurma Mbyllur	Ushurma Mbyllur
			31.12.2018	31.12.2017
I	AKTIVET AFATSHKURTRA			
1	Aktive monetare	4.1	94,950,554	51,086,709
2	Derivative dhe aktive të mbajtura për tregëtim		-	-
	TOTALI 2		94,950,554	51,086,709
3	Aktive të tjera financiare afatshkurtra			
a	Llogari/Kerkesa të arketueshme (Kliente)	4.2	214,767,337	117,179,652
b	Llogari/Kerkesa të tjera të arketueshme	4.3	35,606,560	63,836,493
	TOTALI 3		250,373,897	181,016,146
4	Inventari			
a	Lendet e para		-	-
b	Prodhim në proces		-	-
c	Produkte të gatshme		-	-
d	Mallra për rishitje	4.4	1,360,794,268	1,331,468,888
e	Parapagesat për furnizime		1,588,079	-
	TOTALI 4		1,362,382,347	1,331,468,888
5	Aktive biologjike afatshkurtra			-
6	Aktivet afatshkurtra të mbajtura për shitje			-
7	Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	4.5	1,885,607	7,589,227
	TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTRA (I)		1,709,592,405	1,379,660,969
II	AKTIVET AFATGJATA			
1	Investimet financiare afatgjata			
	TOTALI 1			
2	Aktive afatgjata materiale			
a	Toka	4.6	1,500,000,000	1,500,000,000
b	Ndertesa	4.6	1,980,036,748	2,080,683,578
c	Makinieri dhe pajisje	4.6	44,717,545	39,178,538
d	Aktive të tjera afatgjata materiale (me vl.kontab.)	4.6	121,246,932	148,396,122
e	Aktive Materiale në proces	4.6	-	-
	TOTALI 2		3,646,001,224	3,768,258,238
3	Aktivet Biologjike afatgjata			
4	Aktivet afatgjata jomateriale		27,574,865	24,018,312
a	Emri i mire			-
b	Shpenzimet e zhvillimit			-
c	Aktive të tjera afatgjata jomateriale (software)	4.6	27,574,865	24,018,312
	TOTALI 4		27,574,865	24,018,312
5	Kapitali aksionar i papaguar	4.7	200,000	200,000
6	Aktive të tjera afatgjata			
	TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA (II)		3,673,776,088	3,792,476,550
	TOTALI I AKTIVEVE (I+II)		5,383,368,493	5,179,137,520



Shënimet shoqëruese 4.1 deri në 4.15 janë pjesë përbërse e këtyre pasqyrave financiare

Pasqyrat Financiare 2018

MEGATEK sha BILANCI KONTABËL

Për vitet ushtrimor të mbyllur më 31.12.2018 dhe 31.12.2017

(Të gjitha balancat janë në lekë).

			Ushtrimi Mbyllur	Ushtrimi Mbyllur
	DETYRIMET DHE KAPITALI	Shënime	31.12.2018	31.12.2017
I	DETYRIMET AFATSHKURTRA			
1	Derivativet			
2	Huamarrjet		1,022,359,235	1,282,527,683
a	Huate dhe obligacionet afatshkurtra (overdraft)	4.8	1,022,359,235	1,282,527,683
	TOTALI 2		1,022,359,235	1,282,527,683
3	Huate dhe parapagimet			
a	Te pagueshme ndaj furnitoreve	4.10	1,329,190,925	1,036,149,380
b	Te pagueshme ndaj punonjësve	4.9	6,708,224	5,623,200
c	Detyrimet tatimore	4.9	36,884,453	8,408,372
d	Hua te tjera	4.9	969,063,338	894,943,249
e	Parapagimet e arketuara		-	-
f	Shpenzime për t'u shperndare	4.9	-	440,241
g	Detyrime te tjera	4.9	5,532,838	
	TOTALI 3		2,347,379,778	2,155,564,442
4	Grantet dhe te ardhurat e shtyra			
5	Provizionet afatshkurtra			
	TOTALI I DETYRIMEVE AFATSHKURTRA (I)		3,369,739,013	3,438,092,124
II	DETYRIME AFATGJATA			
1	Huate afatgjata		800,213,097	979,096,524
a	Hua, bono dhe detyrime nga qeraja financiare	4.11	800,213,097	979,096,524
b	Bonot e konvertueshme			
	TOTALI II		800,213,097	979,096,524
2	Huamarrje te tjera afatgjata			
	TOTALI III DE TYRIMEVE AFATGJATA (II)		800,213,097	979,096,524
	TOTALI I DE TYRIMEVE (I+II)		4,169,952,110	4,417,188,648
III	KAPITALI			
1	Aksionet e pakices			
2	Kapitali qe i perket aksionareve te shoqerise meme			
3	Kapitali aksionar	4.12	1,519,000,000	1,519,000,000
6	Rezerva statutore		9,000,000	-
7	Rezerva ligjore	4.12	4,590,804	190,804
8	Rezerva te tjera	4.12	(473,989,643)	(473,989,634)
9	Fitimet e pashperndara	4.12	97,347,712	19,192,711
10	Fitimi (humbja) e vitit financiar	4.13	57,467,511	91,654,990
	TOTALI I KAPITALIT III (1-10)		1,213,416,383	1,155,948,872
	TOTALI I DE TYRIMEVE KAPITALIT (I+II+III)		5,383,368,493	5,573,137,520

Shënimet shoqëruese 4.1 deri në 4.15 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

MEGATEK sha
+ 355 4 23 88 353
www.megateksa.com

Pasqyrat Financiare 2018

MEGATEK sha BILANCI KONTABËL

Për vitet ushtrimor të mbyllur më 31.12.2018 dhe 31.12.2017
(Të gjitha balancat janë në lekë).

PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE			Ushtrimi Mbyllur	Ushtrimi Mbyllur
Nr.	PERSHIKRIMI I ELEMENTEVE	Nr. ref.	31.12.2018	31.12.2017
1	Shitjet neto	4.12	2,297,677,014	2,043,492,857
2	Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit	4.12	38,958,873	51,584,519
3	Ndryshim ne inventarin e produkteve te gatesh dhe Pr. Proc.			
	TOTALI I TE ARDHURAVE (1-2)		2,336,635,888	2,095,077,377
4	Materiale te konsumuara	4.12	(4,466,846,947)	(4,474,621,453)
5	Kostot e punes		(94,574,459)	(86,455,470)
a	Pagat e personelit	4.12	(80,874,321)	(65,224,104)
b	Shpenzime per sigurime shoqerore dhe shendetesore	4.12	(13,699,838)	(11,231,367)
6	Amortizimet dhe zhvleresimet	4.12	(159,972,799)	(161,356,457)
7	Shpenzime te tjera	4.12	(596,586,751)	(250,591,016)
	TOTALI I SHPENZIMEVE (4-7)		(2,317,980,657)	(1,963,024,398)
9	Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore (1+2+/-3-8)		18,655,231	132,052,979
10	Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njesi te kon			
11	Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesmarrjet			
12	Te ardhurat dhe shpenzimet financiare		49,479,053	(29,754,447)
a	Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime			
	te tjera financiare afatgjata			
b	Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat	4.12	(63,331,307)	(77,868,525)
c	Fitimet (humbjet) nga kursi i kembimit	4.12	111,705,792	44,965,295
d	Te ardhura dhe shpenzime te tjera financiare	4.12	1,104,569	3,148,783
	TOTALI I TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE FINANCIARE (A-D)		49,479,053	(29,754,447)
14	Fitimi (humbja) para tatimit (9+/-13)		68,134,283	102,298,533
15	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	4.13	(10,666,777)	(10,643,542)
16	Fitimi (humbja) neto e vitit financiar (14-15)		57,467,506	91,654,990

MEGATEK Sh.a
KODI 16070500
Superstrada Tiranë - Durrës, Km 6, Tiranë
+ 355 4 23 88 333
www.megateksa.com

Shënimet shoqëruese 4.1 deri në 4.15 janë pjesë përbërse e këtyre pasqyrave financiare

Pasqyrat Financiare 2018

MEGATEK sh.a BILANCI KONTABËL

Për vitet ushtrimor të mbyllur më 31.12.2018 dhe 31.12.2017
(Të gjitha balancat janë në lekë).

Nr	PASQYRA E CASH-FLOW - INDIREKTE		Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi i Mbyllur
			31.12.2018	31.12.2017
1-Fluksi parave nga veprimtaria e shfrytëzimit			592,482,516	492,516,351
1.1	Fitimi para tatimit		68,134,284	102,298,533
	Rregullime per :			
a	Amortizimin		159,972,799	161,356,458
b	Humbje nga kembimet valutore			
c	Te ardhura nga Investimet			
d	Shpenzime per interesa		63,331,307	77,868,525
1.2	Rritje/renie ne tepricen e kerkesave te arketueshme nga aktiviteti,si dhe kerkesave te arketueshme te tjera		(71,445,831)	529,149
1.3	Rritje/renie ne tepricen e inventarit		(29,325,380)	(160,077,041)
1.4	Rritje/renie ne tepricen e detyrimeve, per tu paguar nga aktiviteti		401,815,336	310,540,728
MMI te perfituara nga aktivitetet			(73,998,080)	(88,512,067)
1.5	Interesi i paguar		(63,331,307)	(77,868,525)
1.6	Interesi i llogaritur			
1.7	Tatime te parapaguara (tatim fitimi per tu paguar)		(10,666,773)	(10,643,542)
MMI neto nga aktivitetet e shfrytëzimit			518,484,436	404,004,284
2-Fluksi monetar nga veprimtari te investuese				
2.1	Blerja e njesisese kontrolluar X minus parate e Arketuara			
2.2	Blerja e aktiveve afatgjata materiale		(41,272,338)	(193,106,379)
2.3	Te ardhura nga kurset e kembimit			
2.4	Interesi i arketuar			
2.5	Dividentet e arketuar			
MMI neto te perdorura ne veprimtari te investuese			(41,272,338)	(193,106,379)
3-Fluksi monetar nga aktivitetet financiare				
3.1	Te ardhura nga emetimi i kapitalit aksioner			
3.2	Te ardhura nga huamarrje afatgjata		(439,051,875)	(161,754,481)
3.3	Shpenzime te shtyra dhe parapagime		5,703,621	(12,512,535)
3.4	Te tjera financiare (grante)		-	(1,290,030)
MMI neto e perdorur ne veprimtari te financiare			(433,348,254)	(175,557,046)
Rritja/ Renia neto e mjeteve monetare			43,863,844	35,340,859
Mjetet monetare ne fillim te periudhes kontabel			51,086,709	15,745,850
Mjetet monetare ne fund te periudhes kontabel			94,950,554	51,086,709

MEGATEK Sh.a
KESH 607050Q
Superstrada Tirane - Durrës, Km 6, Tirane
www.megateksh.a.com

Pasqyrat Financiare 2018

MEGATEK sha BILANCI KONTABËL

Për vitet ushtrimor të mbyllur më 31.12.2018 dhe 31.12.2017
(Të gjitha balancat janë në lekë).

PASQYRA E NDRYSHIMEVE KAPITALIT	Kapitali i përbërësve (Ekipi)	Rezervat e fitimit	Rezervat e rritjes	Rezervat e detyrueshme	Fitimi i fitimit të përbërësve	Fitimi i fitimit të rritjes	Totali
Pozicioni më 31.12.2015	1,519,000,000	90,804		(367,324,094)	(63,165,476)	16,966,007	1,105,517,241
Efekt ndryshimeve në politikat kontabël	-						-
Pozicioni i rregulluar	1,519,000,000	90,804		(367,324,094)	(63,165,476)	16,966,007	1,105,517,241
Fitimi neto për periudhën kontabël						(41,223,360)	(41,223,360)
Shperdarja e fitimit të periudhës kontabël					16,966,007	(16,966,007)	
Dividentët e paguar							-
Emetim i kapitalit aksionar							-
Rritje e rezervës së kapitalit				(106,615,540)	106,615,540		-
Aksione të thesarit të riblera							-
Pozicioni më 31.12.2016	1,519,000,000	90,804		(473,989,634)	60,416,072	(41,223,360)	1,064,293,882
Efekt ndryshimeve në politikat kontabël	-						-
Pozicioni i rregulluar	1,519,000,000	90,804		(473,989,634)	60,416,072	(41,223,360)	1,064,293,882
Fitimi neto për periudhën kontabël						91,654,990	91,654,990
Shperdarja e fitimit të periudhës kontabël					(41,223,360)	(41,223,360)	
Dividentët e paguar							-
Emetim i kapitalit aksionar							-
Rritje e rezervës së kapitalit							-
Aksione të thesarit të riblera							-
Pozicioni më 31.12.2017	1,519,000,000	90,804		(473,989,634)	19,192,712	91,654,991	1,155,948,872
Destinimi i Fitimit 2018		4,500,000	9,000,000		78,154,991	(91,654,991)	-
Fitimi neto për periudhën kontabël						57,467,511	57,467,511
Shperdarja e fitimit të periudhës kontabël							-
Dividentët e paguar							-
Emetim i kapitalit aksionar							-
Rritje e rezervës së kapitalit							-
Aksione të thesarit të riblera							-
Pozicioni më 31.12.2018	1,519,000,000	4,590,804	9,000,000	(473,989,643)	97,347,702	57,467,511	1,213,416,383

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtimi i MEGATEK sha dhe janë firmosur nga:

Drejtor Ekzekutiv

Dionis TEQJA

Drejtor Financie

Eriold JANKO

Shënime shprehëse 4.1 deri në 4.15 janë pjesë përbërse e këtyre pasqyrave financiare

Pasqyrat Financiare 2018

MEGATEK sh.a
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin ushtrimor të mbyllur më 31.12.2018
(Të gjitha balancat janë në lekë).

1. Të përgjithshme

Historia dhe Krijimi

Shoqëria "Megatek " sh.a është regjistruar si shoqëri Anonime pranë QKR – Tiranë, më datë 07.04.2008.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas despozitave përkatëse të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare, Ligjit Nr. 9228 datë 29.04.2004 Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, nga Statuti i saj si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore të legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Shoqëria Megatek sh.a, ka një kapital të regjistruar në QKR për 1.519.000.000 lekë, i cili zotërohet nga ortakët :

- Z. Dionis TEQJA me 99.99% të kuotave të Kapitalit
- Z. Apostolos PEFKOS me 0.01% të kuotave të Kapitalit.

Kapitali i nënshkruar, sipas vendimit të Asamblesë së datës 15.06.2015 nuk ka pësuar ndryshime .

Me vendimin e dorëzuar pranë QKR – Tiranë më datë: Z. Endri XHORI ka ushtruar detyrat e Administratorit të shoqërisë, deri në datën 28.02.2019 , dhe mbas kesaj deri me datë 28.02.2022 është emëruar administrator i shoqërisë Z.Dionis Teqja.

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në lekë shqiptare (Lekë) meqenëse kjo është monedha në të cilën janë kryer pjesa më e madhe e transaksioneve të shoqërisë.

Aktiviteti Kryesor

Shoqëria ka si objekt kryesor të veprimtarisë së saj:

Tregetimin me shumicë të produkteve industriale, import-eksport të produkteve industriale, prodhimin e produkteve industriale, menaxhim qendre tregëtare, ushtrimin e cdo lloj aktiviteti dytësor që lidhet me ushtrimin e aktiviteteve të mësipërme, si dhe ushtrimin e aktivitetit bar bufe dhe cdo lloj aktiviteti tjetër dytësor që lidhet me ushtrimin e këtij aktiviteti.



Pasqyrat Financiare 2018

MEGATEK sha
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin ushtrimor të mbyllur më 31.12.2018
(Të gjitha balancat janë në lekë).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

a) Përgatitja e Pasqyrave Financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (S.K.K) të Ndryshuara, me Urdhërin Nr. 64, datë 22.07.2014.

Këto pasyra financiare janë individuale dhe nuk reflektojnë instrumenta financiarë të investimeve në pjesëmarrje kapitali. Për këtë arsye nuk është paraqitur pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

b) Mënyra e Vlerësimit

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit të të drejtave të konstatuara. Pasqyrat financiare të shoqërisë janë vjetore dhe përgatiten çdo vit më 31 Dhjetor.

c) Monedha Funksionale

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në ALL (Lekë), e cila është monedha operuese e Shoqërisë. Të gjitha informacionet janë shprehur në vlerën e tyre duke u rrumbullakosur në (1) lekë.

d) Vlerësimet kontabël

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon gjykimin, vlerësimin dhe supozimin në nivel drejtues, të efektit nga aplikimit të politikave kontabël në vlerat e raportuara të aseteve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve.

Vlerësimet dhe supozimet janë parë si një proces i vazhdueshëm. Në rastet kur politikat e reja kontabël kanë patur efekt në vlerësimet kontabël, kjo është pasqyruar në bazë të parimit të njohjes në prospektiv.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të paraqitura në vijim janë një përmbledhje e politikave kontabël të zbatuara nga shoqëria në vlerësimin e treguesve të saj financiarë. Këto politika janë aplikuar duke marrë për bazë kuadrin konceptual të përgatitjes së pasqyrave financiare, mbi parimin kuptueshmërisë, rëndësisë, besueshmërisë dhe krahasueshmërisë.

Pasqyrat Financiare 2018

MEGATEK sha

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin ushtrimor të mbyllur më 31.12.2018

(Të gjitha balancat janë në lekë).

a) Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja, më 31.12.2018 janë:

EURO : LEK 123.42

USD : LEK 107,82

b) Instrumentat Financiare


Është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar për një njësi ekonomike, si dhe një detyrim financiar ose instrument kapitali për një njësi ekonomike tjetër. Një njësi duhet të njohë një aktiv financiar ose një detyrim financiar vetëm kur njësia bëhet pjesë e kushteve kontraktuale të instrumentit.

Kur një aktiv financiar ose një detyrim financiar njihet fillimisht, një njësi duhet ta masë atë me kostot e transaksionit (duke përfshirë edhe çmimin e transaksionit) përveç rasteve kur marrëveshja përbën në thelb, një transaksion financiar. Një transaksion financiar mund të jetë, për shembull, kur shiten mallra apo shërbime dhe kur pagesa shtyhet përtej afateve normale të tregtisë ose kur ajo është financuar me një normë interesi që nuk është një normë tregu. Nëse marrëveshja përbën një transaksion financiar, njësia duhet të masë aktivin financiar ose detyrimin financiar me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me normën e interesit të tregut për një instrument të ngjashëm borxhi.

Në fund të çdo periudhe raportimi, një njësi duhet të vlerësojë nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit të ndonjë aktivi financiar që matet me kosto ose me kosto të amortizuar. Nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit, njësia duhet të njohë menjëherë një humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje.

c) Kostot e Huamarrjes

Kostot e huamarrjes përfshijnë interesin e paradhënies bankare dhe huave afatshkurtëra dhe afatgjata. Kostot e huamarrjes njihen si shpenzim në periudhën që ato janë shkaktuar pavarësisht se si huatë janë aplikuar. Kostot e huamarrjes, janë edhe huatë midis personave jo-bankë, marrëdhënia e të cilëve rregullohet sipas kushteve kontraktuale.



Pasqyrat Financiare 2018

MEGATEK sha
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin ushtrimor të mbyllur më 31.12.2018
(Të gjitha balancat janë në lekë).

d) Kërkesat për t'u arkëtuar

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në para regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Në përputhje me parimin e kompensimit të përshkruar në paragrafet 64 dhe 65 të SKK 1 "Parimet e përgjithshme për përgatitjen e pasqyrave financiare", aktivet dhe detyrimet do të kompensohen në bilanc nëse njësia ekonomike raportuese ka të drejtë ligjore për një kompensim të tillë dhe ekziston mundësia që ajo do ta përdorë këtë të drejtë.

e) Detyrimet financiare

Detyrimet financiare janë klasifikuar sipas llojit të marrëveshjes kontraktuale. Huatë e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parë, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

f) Risku i kreditimit

Risku i kreditimit të Shoqërisë kryesisht i vishet kërkesave për arkëtim dhe aktiveve të tjera të saj. Gjëndjet e paraqitura në bilancin kontabël janë zvogëluar nga provizionet (shumat e parashikuara) për kërkesat e dyshimta për arkëtim, të vlerësuara nga drejtimi i shoqërisë mbi bazën e eksperiencës së mëparshme dhe vlerësimit të mjedisit ekonomik aktual.

g) Aktivet afatgjata materiale (AAM-të)

Aktivët afatgjata materiale (AAM-të) paraqiten me shuma të rivlerësuara minus zhvlerësimin. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me koston historike minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Por shuma e rivlerësimit njihet si e ardhur në pasqyrën e të ardhurave, për sa kohë dhe në atë masë që ajo anulon humbjen nga rivlerësimi i të njëjtit aktiv në periudhat kontabël paraardhëse. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave. Por shuma e humbjes nga rivlerësimi debitohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta në zërin "Rezerva Rivlerësimi", për sa kohë dhe në atë masë që ajo kompenson një gjendje kreditore që mund të ekzistojë nga rivlerësime të mëparshme të këtij aktivi. Amortizimi llogaritet mbi bazën e metodës lineare për ndertësat dhe mbi bazën e vlerës së mbetur

Pasqyrat Financiare 2018

MEGATEK sha
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin ushtrimor të mbyllur më 31.12.2018
(Të gjitha balancat janë në lekë).

për aktivet e tjera materiale afatgjata pa tejkaluar kufirin maksimal të miratuar me ligje dhe akte të tjera nenligjore .

Normat maksimale të zbatuara për vitin 2018 janë:

Ndërtesa	5 %
Instalime teknike dhe makineri	20%
Mjete transporti	20%
Paisje zyre	20%
Paisje informatike	25%

h) Inventarët

Inventarët janë paraqitur me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto përbëhet nga cmimi i mallrave dhe, në rastet kur është e aplikueshme, koston e transportit dhe ato kosto të përgjithshme që janë ndeshur për të sjellë inventarët në vendin dhe kushtet aktuale të magazinimit. Kosto është llogaritur duke përdorur metodën FIFO. Vlera neto e realizueshme përfaqëson cmimin e vlerësuar të shitjes minus koston e vlerësuar të përfundimit dhe koston e marketingut, shitjes dhe shpërndarjes.

i) Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftueshme në marrjen e përfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlllogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet njihen atëherë kur ato sigurohen prej të tretëve dhe në të njëjtin ushtrim kontabël me të ardhurat e lidhura.

j) Tatimin mbi fitimin

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin përfaqëson shumën e tatimit për t'u paguar për vitin ushtrimor 2018. Tatim fitimi i pagueshëm për vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshëm për vitin ushtrimor 2018 si dhe në rezultatin e humbjeve të mbartura për tre vitet e fundit fiskale. Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi neto që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sepse ai përjashton zëra të të ardhurave dhe shpenzimeve që janë të tatueshme apo të zbritshëm në vite të tjerë dhe gjithashtu përjashton ato zëra që nuk janë kurrë të tatueshëm apo të zbritshëm. Detyrimi i shoqërisë për tatim fitimin e vitit llogaritet duke përdorur normat e tatimit të përcaktuara nga legjislacioni shqiptar për kontabilitetin në Shqipëri. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin është 15 % (2017 – 15 %).



Pasqyrat Financiare 2018

MEGATEK sha
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
 Për vitet ushtrimor të mbyllur më 31.12.2018
 (Të gjitha balancat janë në lekë).

4. Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare

4.1 Aktive monetare (likuiditete në arkë dhe bankë)

Gjëndjet e mjeteve monetare në bankë dhe arkë, në lekë dhe valutë, në datat 31 Dhjetor 2018 dhe 31 Dhjetor 2017 janë si më poshtë:

Pershkrimi	Monedha	Me date 31 Dhjetor 2018		Me Date 31 Dhjetor 2017	
		Në Lekë	Në Valutë	Në Lekë	Në Valutë
Banka në Leke	ALL	36,769,562		25,218,359	
Banka në USD	USD	1,188,320	11,021	670,951	7402
Banka në Euro	EUR	2,409,531	19,523	603,041	4536
Arka Në leke	ALL	12,723,339		19,972,743	
Arka në USD	USD	119,380	1,107	806,142	7256
Arka në Eur	EUR	7,986,296	64,708	3,815,463	28698
Garanci Bankare për Institucione Doganore dhe Tatimore	ALL	17,000,000			
Garanci Bankare , për tender	ALL	16,754,126			
Totali		94,950,553.89		51,083,708.73	

Gjëndjet e llogarive të likuiditeteve të paraqitura në pasqyrat financiare janë të njëjta me të dhënat e kontabilitetit rrjedhës dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventarëve fizikë të monedhave. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, janë konvertuar në lekë duke përdorur kursin e këmbimit të fundit të ushtrimit të Bankës së Shqipërisë. Garancite Bankare për institucionet Doganore dhe tatimore , janë 10,000,000 ALL Garanci Bankare Lëshuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për autorizimin e magazinës doganore dhe 7,000,000 leke është garanci lëshuar për DPT për çështje gjyqësore . Ndërsa garancia Bankare në vlerën 16,754,126 leke perfqson garanci bankare të lëshuar për furnitorë të ndryshëm.

4.2 Inventari

Inventari përbëhet nga mallra të ndryshme industriale si materiale elektrike, hidraulike, paisje ndricimi, paisje hidrosanitare, mobilje, kopshtari etj. për vlerën 1,360,794,268 lekë. Gjëndjet e inventarit në fillim dhe në fund të ushtrimit paraqiten:

Pershkrimi	Me date 31 Dhjetor 2018	Me Date 31 Dhjetor 2017
Mallra për rishitje	1,360,794,268	1,331,468,888
Totali	1,360,794,268	1,331,468,888

Vlerat e inventarit të paraqitura më sipër, përputhen me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike të kryera në fund të ushtrimit 2018. Inventari është vlerësuar me vlerën më të ulët mes koston së marrjes dhe vlerës neto të realizueshme dhe nuk është nevojë për zhvlerësime të tij.

Shënimet shoqëruese 4.1 deri në 4.15 janë pjesë përbërse e këtyre pasqyrave financiare

Pasqyrat Financiare 2018

MEGATEK sha

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitet ushtrimor të mbyllur më 31.12.2018

(Të gjitha balancat janë në lekë).

4.3 Kërkesa të Arkëtueshme-Klientë

Shoqëria nuk ka përqëndrim të rëndësishëm të riskut të kreditimit, me një zbulim të shpërndarë në një numër të madh të tretësh dhe klientësh. Në raport me kapitalin e shoqërisë, kemi një përqëndrim të ulët të rriskut të arkëtimit nga shitjet. Drejtimi nuk ka vlerësuar klient potencialë në pamundësi likuidimi.

Pershkrimi	Me date 31 Dhjetor 2018	Me Date 31 Dhjetor 2017
Llogari/Kerkesa te arketueshme	214,767,337	117,179,652
Totali	214,767,337	117,179,652

4.4 Kërkesa të tjera te Arkëtueshme


Kërkesa të tjera të arkëtueshme, përbëhet nga tatimin fitimi i parapaguar për shumën 2,407,368 lekë objekt Apeli pranë Gjykatës së Apelit, dhe 2,997,180 lekë gjendje kreditore për tatim fitimin e periudhës kontabël 2017 ne pritje te përfundimit te procesit gjyqësor , depositë garancie ligjore për cështjen gjyqësore pranë DPD për shumën 12,569,647 lekë, gjendje kreditore të llogarisë operacionale me Degët Doganore në shumë 5,895,357 leke , 577,400 leke taksa vendore ne per tu kthyer, 78,310 parapagime per taksa gjysore te paguara, 10,153,868 leke janë Interesa Bankare te mbajtura nga institucionet bankare , te cilat janë arkëtuar ne Janar 2019 , dhe 927,431 leke te tjera te arketueshme.

Pershkrimi	Me date 31 Dhjetor 2018	Me Date 31 Dhjetor 2017
Kerkesa te tjera te Arketueshme	35,606,560	63,336,493
Totali	35,606,560	63,336,493

4.5 Të tjera aktive afatshkurtëra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra, përbëhen nga 1,885,607 lekë, te cilat kanë lidhje me kontratën me afat të sigurimit të ndërtesës tregtare. Shpenzimet e shtyra janë amortizuar në bazë mujore.

Pershkrimi	Me date 31 Dhjetor 2018	Me Date 31 Dhjetor 2017
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	1,885,607	7,589,227
Totali	1,885,607	7,589,227



Pasqyrat Financiare 2018

MEGATEK sha
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
 Për vitet ushtrimor të mbyllur më 31.12.2018
 (Të gjitha balancat janë në lekë).

4.6 Aktive Afatgjata

Gjëndjet dhe lëvizjet e aktiveve afatgjata materiale në pasqyrat financiare paraqiten si vijon:

	Gjendjet dhe lëvizjet	Toka	Ndertesa	Makineri dhe pajisje	Mjete transporti	Aktivet e tjera afatgjata materiale	Totali
A	Kosto e AAM-ve me 01.01.2018	1,500,000,000	2,556,833,528	50,284,652	46,906,375	367,066,255	4,521,090,811
	Shtesat		10,875,376	8,195,050	210,000	25,744,898	45,025,324
	Pakesimet			(121,678)	(20,120)	(9,262,989)	(9,404,787)
	Kosto e AAM-ve 31.12.2018	1,500,000,000	2,567,708,904	58,358,024	47,096,255	383,548,164	4,556,711,348
							-
B	Amortizimi AAM-ve 01.01.2018	-	(476,149,949)	(11,106,032)	(21,420,657)	(220,137,621)	(728,814,259)
	Amortizimi ushtrimit		(111,522,207)	(7,778,931)	(5,145,340)	(35,526,321)	(159,972,799)
	Amortizimi për daljet e AAM-ve	-		41,157	13,960	7,354,595	7,409,712
	Amortizimi AAM-ve 31.12.2018	-	(587,672,156)	(18,843,806)	(26,552,037)	(348,309,347)	(881,377,346)
							-
C	Zhvlerësimi AAM-ve 01.01.2018						-
	Shtesat						-
	Pakesimet						-
	Zhvlerësimi AAM-ve 31.12.2018						-
							-
D	Vlera neto e AAM-ve 01.01.2018	1,500,000,000	2,080,683,579	39,178,620	25,485,719	146,928,634	3,792,276,551
							-
	Vlera neto e AAM-ve 31.12.2018	1,500,000,000	1,980,036,747	39,514,218	20,544,219	135,238,817	3,675,336,089

Vlerat dhe klasifikimi në grupe i AAM-ve të pasqyruara në bilanc dhe në tabelën e mësipërme janë të përputhura me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike që shoqëria ka kryer në fund të muajit dhjetor 2018. Si politikë kontabël për kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqëria ka zgjedhur modelin e koston (SNK-5). Vlerësimi fillestar në momentin e marrjes në inventar është bërë me koston e marrjes dhe në datën e mbylljes së bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Drejtimi mendon se përgjithësisht për këtë ushtrim kontabël, nuk ka shenja të rënies në vlerë të AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvlerësime.

Metodat dhe normat e amortizimit të AAM-ve të përdorura janë ato që përdoren për qëllime fiskale. (shih shenimin nr 3.g)-Norma e llogaritur e amortizimit si shpenzim, nuk i tejkalon kufijtë e njohur nga Ligji për Tatimin mbi të Ardhurat.

Superstrada Tiranë - Durrës, Km 6, Tiranë

+36 23 88 333

Pasqyrat Financiare 2018

MEGATEK sha
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitet ushtrimor të mbyllur më 31.12.2018
(Të gjitha balancat janë në lekë).

4.7 Kapitali aksionar i papaguar

Përfaqëson detyrmin e ortakut mbi Kapitalin Themeltar të papaguar për 200,000 lekë.


4.8 Detyrime afatshkurtëra-Huamarrjet

Huamarrjet afatshkurtra në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabël 2018 paraqiten si vijon:

Pershkrimi	Me date 31 Dhjetor 2018	Me Date 31 Dhjetor 2017
Huate dhe obligacionet afatshkurtra	1,022,359,235	1,282,527,683
Totali	1,022,359,235.02	1,282,527,682.79

Shoqëria ka marrë një hua bankare overdraft nga Alpha Bankë dhe gjendja e saj më 31.12.2018 është 4,023,598.2 Euro e konvertuar me kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë më 31.12.2018 në shumën 496,592,495 Lekë.

Shoqëria ka marrë një hua bankare overdraft nga Tirana Bankë dhe gjendja e saj më 31.12.2018 është 4,259,980 Euro e konvertuar me kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë më 31.12.2018 në shumën 525,766,740 Lekë.



Pasqyrat Financiare 2018

MEGATEK sha
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
 Për vitet ushtrimor të mbyllur më 31.12.2018
 (Të gjitha balancat janë në lekë).

4.9 Detyrime afatshkurtëra-huatë dhe parapagimet

Huatë dhe parapagimet afatshkurtëra në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabël 2018 paraqiten si vijon:

Pershkrimi	Me date 31 Dhjetor 2018	Me Date 31 Dhjetor 2017
	Leke	Leke
Te pagueshme ndaj furnitorëve	1,329,190,925	1,036,149,380
Te pagueshme ndaj punonjesve	6,708,224	5,623,200
Detyrimet tatimore	36,884,453	8,408,372
Hua te tjera	969,063,338	894,943,249
Parapagimet e arketuara	-	-
Shpenzime per t'u shperndare	-	440,241
Detyrime te tjera	5,532,838	
Totali	2,347,379,778	1,945,564,442

Të pagueshme ndaj punonjësve përfaqësojnë detyrimin për pagat në shumën 6,708,224 lekë per muajin dhjetor 2018 , te paguara ne Janar 2019.

Detyrimet tatimore, përfaqësojnë detyrimin për sigurimet shoqërore shendetsore dhe Tap te muajit Dhjetor 2018 në shumën 2,266,352 lekë, tatimi në burim në shumën 69,653 lekë, (TVSH) të pagueshme për muajin dhjetor 2018 në shumën 31,864,330 lekë dhe tatim fitimi per vitin 2018 ne shumen 2,684,118 leke.

Hua të tjera përbëhet kryesisht nga kreditimi nëpërmjet kompanive të grupit. Shoqëria, ka nënshkruar marrëdhënie kontraktuale të financimit pa interes. Financimi, nëpërmjet shoqërive të grupit ka rritur garancinë e likuiditetit dhe atë të operacioneve tregtare.

Shuma prej 5,532,838 leke perfaqeson parapagimet e marra nga klientet ne Shumen 2,228,886 leke dhe pjesa e mbetur jane detyrime te tjera Doganore .

4.10 Detyrime ndaj Furnitorëve

“Të pagueshme ndaj furnitorëve” pasqyron detyrimet ndaj furnitorëve për blerjen e mallrave e shërbimeve të pa likujduar në fund të ushtrimit. Shoqëria ka përgatitur inventarët kontabël dhe shuma e llogarisë sintetike është e barabartë me shumën e llogarive analitike të mpajtura për cdo furnitor.

Detyrimi ndaj furnitorëve reflekton edhe marrëdhënien me shoqëritë e grupit. Vlerësohet se shoqëria nuk ka një përqëndrim të riskut të likuidimeve, ndaj furnitorëve jo të grupit, krahasuar kjo me nivelin e detyrimeve, nivelin e likuiditetit dhe atë solvabilitetit.

Pasqyrat Financiare 2018

MEGATEK sha
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
 Për vitet ushtrimor të mbyllur më 31.12.2018
 (Të gjitha balancat janë në lekë).

4.11 Detyrime Afatgjata-Huatë afatgjata

Huatë afatgjatë në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabël 2018 paraqiten si vijon:

Shoqëria ka marrë një hua bankare afatgjatë nga Alpha Bankë, dhe gjëndja e saj më 31.12.2018 është 3,066,035 Euro e konvertuar me kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë më 31.12.2018 në shumën 378,410,063 Lekë.

Shoqëria ka marrë një hua bankare afatgjatë nga Tirana Bankë, dhe gjëndja e saj më 31.12.2018 është 3,066,034 Euro e konvertuar me kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë më 31.12.2018 në shumën 378,409,965 Lekë.

Shoqëria ka marrë një hua bankare afatmesme nga Tirana Bankë në lekë dhe gjëndja e saj më 31.12.2018 është 43,393,070 Lekë.

Pershkrimi	Me date 31 Dhjetor 2018	Me Date 31 Dhjetor 2017
Huate afatgjata	800,213,097	979,096,524
Totali	800,213,097	979,096,524

4.12 Kapitale të veta.

Gjatë ushtrimit kontabël 2018, nuk ka patur ndryshime në raportet e zotërimit të Aksioneve. Raporti i aksioneve përbëhet nga :

Shoqëria Megatek sh.a , ka një kapital të regjistruar në QKR për 1.519.000.000 lekë, i cili zotërohet nga ortakët :

- Z. Dionis Teqja me 99.99% të kuotave të Kapitalit
- Z. Apostolos Pefkos me 0.01% të kuotave të Kapitalit.

Kapitali përbëhet si më poshtë:

Pershkrimi	Me date 31 Dhjetor 2018	Me Date 31 Dhjetor 2017
Kapitali aksionar	1,519,000,000	1,519,000,000
Rezerva statutore	9,000,000	-
Rezerva ligjore	4,590,804	90,804
Rezerva të tjera	(473,989,643)	(473,989,634)
Fitimet e pashperndara	97,347,712	19,192,711
Fitimi (humbja) e vitit financiar	57,467,511	91,654,990
Totali	1,213,416,383	1,155,948,872

Fitimi i vitit 2017 , ne shumen 91,654,990 leke eshte destinuar si vijon 4,500,000 leke rezerva ligjore ,9,000,000 leke , dhe 78,154,990 leke per mbulimin e humbjeve te mbartura.

Pasqyrat Financiare 2018

MEGATEK sha

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitet ushtrimor të mbyllur më 31.12.2018

(Të gjitha balancat janë në lekë).

4.13 Fitimi (humbja) e vitit financiar


Shpenzimet dhe të ardhurat sipas natyrës

Të ardhura e realizuara gjatë ushtrimit, sipas segmenteve (kategorive) të biznesit paraqitet në vijim. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve janë vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, të zhveshura nga TVSH-ja. Të ardhurat nga shërbimet e tjera janë njohur deri në masën e shpenzimeve të rikuperueshme, të njohura në kontabilitet. (Njohja dhe vlerësimi janë bazuar në SKK-8). Paraqitja në pasqyrat financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve është bërë sipas natyrës së tyre.

Pershkrimi	Me date 31 Dhjetor 2018	Me Date 31 Dhjetor 2017
Te Ardhura nga shitja e Mallrave	2,297,677,014	2,043,492,857
Te Ardhura nga shitje te tjera (Qera dhe komisione)	33,082,802	45,000,103
Te ardhura te tjera rrjedhese	3,084,259	4,251,840
Te Ardhura nga Grantet(730)	-	1,573,542
Te ardhura te tjera korente (750)	1,683,891	29,567
Te ardhura nga shitja e AAM (752)	1,107,922	729,468
Totali	2,336,635,888	2,095,077,377

Konsumi i materialeve, mallrave, per vitin ushtrimor 2018 eshte ne vleren furniturave, punimeve e shërbimeve, të pasqyruara në dokumentat justifikues, janë regjistruar me shumat e paguara ose të pagueshme.

Kostoja e punësimit, pagë dhe sigurime shoqërore, është pasqyruar saktësisht si shpenzim me vlerën e realizuar dhe të dokumentuar. Taksat lokale e taksa e tatime të tjera që lidhen me biznesin, janë llogaritur dhe pasqyruar në llogaritë e ushtrimit. Shpenzimet e tjera që në një masë të konsiderueshme përbëhen nga furnitura, nëntrajtime dhe shërbime nga të tretë paraqitet e analizuar sipas pasqyrës së paraqitur më poshtë.



Pasqyrat Financiare 2018

MEGATEK sha
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitet ushtrimor të mbyllur më 31.12.2018
(Të gjitha balancat janë në lekë).

Pershkrimi	Me date 31 Dhjetor 2018	Me Date 31 Dhjetor 2017
Blerje/shpenzime te materiale te tjera (602)	597,560	-
Blerje energi elektrike (604)	26,868,757	25,711,281
Blerje karburant (604)	4,089,104	4,690,650
Blerje/shpenzime te tjera (608)	4,865,413	3,971,795
Zbritje financiare nga furnitori (609)	-	11,362
Zbritje financiare per klient (610)	601,550	2,499,668
Sherbime nga te tretet -nenkontraktor (611)	2,650	54,113
Qera (613)	5,293,963	4,855,054
Mirmbajtje dhe riparime (615)	26,624,017	14,240,577
Sigurime (616)	3,615,788	3,536,153
Te tjera (618)	22,229,083	25,780,148
Personel jashte njesise (621)	7,105,720	6,426,590
Shpenzime per koncesione , patent (623)	937,903	367,741
Publicitet reklam (624)	73,772,845	57,227,640
Shpenzime ndermjetesimi , konsulence , studim tregu	278,590,000	(0)
Transferime udhetim e dieta (625)	64,741,202	48,607,412
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni (626)	3,392,729	3,171,722
Shpenzime transporti (627)	46,349,454	24,274,732
Sherbime bankare (628)	9,315,959	8,540,991
Tatime dhe taksa vendore (632)	7,668,970	12,260,836
Tatime te tjera (638)	279,116	28,967
Vlera kontabel e AAM te shitura (652)/(6722)	3,015,152	385,688
Subvecione te dhena (653) (sponzorizime)	5,382,706	233,455
Shpenzime pritje dhe perfaqesimi (654)	917,459	1,817,530
Gjoha dhe demshperblime (657)	117,522	981,276
Te tjera tatimore te panjohura (658)	212,127	915,635
Totali	596,586,751	1,250,591,016

[Signature]
MEGATEK Sh.a
 K80607050Q
 Superstrada Tirane - Durrës, Km 6, Tirane
 004 4 23 88 333

[Signature]

Pasqyrat Financiare 2018

MEGATEK sha
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
 Për vitet ushtrimor të mbyllur më 31.12.2018
 (Të gjitha balancat janë në lekë).

▪ Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Janë paraqitur si diferencë e të ardhurave me shpenzimet sipas kërkesave të standarteve.

Pershkrimi	Me date 31 Dhjetor 2018	Me Date 31 Dhjetor 2017
Te Ardhurat nga Interesat 767,667(+)	1,785	2,777
Shpenzimet per interesat 661,668(-)	(63,333,092)	(77,871,301)
Fitime nga kursi i kembimit 769,669(+)	263,657,785	70,806,185
Humbjet nga kursi i kembimit 769,669(-)	(151,950,594)	(25,837,202)
Te ardhura dhe shpenzime te tjera financiare 768,668	1,103,169	3,145,095
Totali	49,479,053	29,754,447

4.14 Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin për ushtrimin kontabël 2018 dhe 2017 janë si vijon:

	Llogaritja e Fitimit Tatimor	Ushtrimi Mbyllur	Ushtrimi Mbyllur
		31.12.2018	31.12.2017
I	FITIMI NETO PARA TATIMIT	68,134,284	102,298,533
II	SHPENZIME TE PAZBRITESHME (+)	2,977,534	4,406,941
1	Amortizime tej normave fiskale		
2	Shpeizime pritje e dhurime tej kufirit tatimor		
3	Gjoha, penalitete, demshperblime	117,522	981,276
4	Provizione qe nuk njihen	-	
5	Shpenzime pa dok. ose jo te rregullta	212,127	914,635
6	Te tjera-materiale jashte perdorimit(pa miratim)	-	
7	Te tjera shpenzime korrente	2,647,885	2,511,029
III	PJESA E HUMBJES SE MBARTUR(-)	-	(35,748,524)
IV	FITIMI (HUMBJA) TATIMOR (I-II-III)	71,111,818	70,956,950
V	Shpenzimi i tatimit fitimit-15%	10,666,773	10,643,542
VI	FITIMI (HUMBJA) E USHTRIMIT	57,467,511	92,654,990

Shënimet shoqëruese 4.1 deri në 4.15 janë pjesë përbërse e këtyre pasqyrave financiare

MEGATEK sha
 + 355 4 23 88 333
 www.megateksa.com


Pasqyrat Financiare 2018

MEGATEK sha
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitet ushtrimor të mbyllur më 31.12.2018
(Të gjitha balancat janë në lekë).

Tatim fitimi i ushtrimit është i llogaritur mbi fitimin e tatueshëm, i cili është rregulluar nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiskal, analizuar në tabelën e mësipërme. Sipas ligjit, shpenzime të pazbritëshme janë konsideruar edhe interesat bankare të ushtrimit në raste të tejkalimit të plotë të huasë krahasuar me katërfishin e kapitaleve të veta. Në këto pasqyra financiare nuk ka pasur tejkalim të këtyre normave. Si shpenzime të panjohura janë njohur gjokat dhe penaltetet nga aktiviteti tregtar si në shumën 117,522 lekë dhe 212,127 lekë shpenzime me dokumentacion jo të rregullt, si dhe të tjera shpenzime korrente për shumën 2,647,885 lekë.

4.15 Ngjarjet pas datës së bilancit dhe vazhdimësia e shfrytëzimit

Shifrat e vitit ushtrimor 2018 janë të krahasueshme me vitin ushtrimor 2017, për arsye se janë bazuar në (S.K.K), dhe nuk ka pasur ndryshime në politikat kontabile nga shodëria. Pas datës 31.12.2018 nuk ka pasur ngjarje materiale të cilat mund të ndikojnë në vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë.



A large, stylized handwritten signature in black ink, likely belonging to a company representative.